



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MAT
KRYETARI

Nr. _____ Prot.

Burrel, më _____.____.2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Drejtuar: Operatorit Ekonomik: “**VISI-JONI**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L31710003T**, me seli:
Tiranë, Tiranë, TIRANË, Rruga “Don Bosko”, Pallati Shekulli, hyrja 1, apartamenti 22.

Procedura e prokurimit: “**E Hapur e Thjeshtuar - Shërbime**”, *prokurim elektronik – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.*

Numri i referencës së procedurës: **REF-00079-04-04-2024**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Shërbim transporti materialesh sipas marrëveshjes me Fondin Shqiptar të Zhvillimit në Bashkinë Mat**”, me fond limit në vlerën: **1 640 000** (një milion e gjashtëqind e dyzet mijë) **lekë pa TVSH**, nga grand i bashkisë në vlerën: 833 333.33 (tetëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre pikë tridhjetë e tre) **lekë pa TVSH**, dhe nga të ardhurat: 806 666.67 (tetëqind e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) **lekë pa TVSH**, me afat realizimi të marrëveshjes kuadër: **12** (dymbëdhjetë) **muaj**.

Publikime të mëparshme: *Po, ka patur* (

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 18, datë 08 Prill 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik: “**SHEHU**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **J66702707S**

Vlera: **1 500 000** (një milion e pesëqind mijë) **lekë pa TVSH.**

2. Operatori Ekonomik: “**VISI-JONI**” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **L31710003T**

Vlera: **1 592 000** (një milion e pesëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH.
Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik: “SHEHU” Sh.p.k., me numër Nipt-i: **J66702707S**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtëm:

❖ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur për pjesëmarrje në tender, dhe në zbatim të vendimit Nr.485/2024, datë 10.05.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik rezulton se, Operatori Ekonomik, shoqëria “SHEHU” Sh.p.k., nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Përzgjedhjes/ Kualifikimit, si më poshtë:

I. Nuk janë përmbushur përcaktimet e pikës 1 gërma “a” dhe “b”/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

➤ **Këto kushte nuk përmbushen nga ana e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur konstatohet se:**

- **Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit nuk është paraqitur sipas formatit të miratuar të shtojcës 9 në DST për shërbime.**

- **Gjithashtu, në seksionin “Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit - A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT” të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, nuk janë deklaruar të gjithë emrat e personave në cilësinë e administratorëve dhe të ortakëve të pasqyruar në ekstraktin historik të regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit., se nuk janë të dënuar/ ose kanë qënë të dënuar për veprat penale të përcaktuara në nenin 76 të LPP-së.**

- **Formulari i Sigurimit të Ofertës me Nr.serial:240601366, datë 15.04.2024, nuk është plotësuar me të dhëna të sakta referuar procedurës aktuale në të cilën ka marrë pjesë me Nr. REF-00079-04-04-2024, por me të dhënat për numrin e referencës të procedurës së mëparshme të anuluar me Nr. REF-94635-02-06-2024.**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik: **“VISI-JONI”** Sh.p.k., me seli: *Tiranë, Tiranë, TIRANË, Rruga “Don Bosko”, Pallati Shekulli, hyrja 1, apartamenti 22*, me numër Nipt-i: **L31710003T**, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej: **1 592 000** (një milion e pesëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Si pasojë, nga ju kërkohet të paraqiteni tek [Bashkia Mat/ Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike, me adresë: Sheshi “Kastriotët”, Nr.1, KP 8001, Burrel] brenda **5 (pesë) ditëve** nga data e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, dhe do të procedohet konform dispozitave ligjore në fuqi të parashikuara nga Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar).

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO

Vendimi Përfundimtar **Nr.485/2024, datë 10.05.2024** i Komisionit të Prokurimit Publik.

Titullari i Autoritetit Kontraktor